



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 63.4 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë dhe me nenin 4.6 të Rregullës së KQZ nr. 01/2013 mbi Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datë 26.05.2021, merr këtë:

V E N D I M

Për regjistrimin e Partisë Politike Bošnjaka Stranka

- I. Regjistrohet Partia Politike "Bošnjaka Stranka" me akronim BS, me kryetar z. Mirzet Džogović.
- II. Partia Politike "Bošnjaka Stranka" – BS, i ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 12 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe obligimet e përcaktuara me nenet 3 dhe 4 të Rregullës zgjedhore 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.
- III. Partia Politike "Bošnjaka Stranka" – BS, obligohet që brenda gjashtë (6) muajve nga data e regjistrimit të mbajë Kuvendin në bazë nenit 15 të Rregullës nr.01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.
- IV. Obligohet Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim që ta përgatit certifikatën e regjistrimit dhe ta regjistroj Partinë Politike "Bošnjaka Stranka" – BS në Regjistrin e Partive Politike të Kosovës.
- V. Obligohet Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim që ta njoftoj partinë politike "Bošnjaka Stranka" – BS, për marrjen e këtij Vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Valdete Daka, Kryetare

Këshillë juridike: Brenda 24 orëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të gjitha palët që kanë interes juridik kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhore për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP.